



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALËSI E MADHE
KESHILLI



Nr. 73/6 prot

Koplik më: 05 /03/2021

V E N D I M

Nr 11 datë 26 / 02 / 2021

PËR

1. "Miratimin e kërkesës së Bashkisë Malësi e Madhe së bashku me dokumentacionin tekniko ligjor përkatës, të z. Pjeter Çukaj, objekti shtëpi banimi e të cilit është dëmtuar nga rënia e zjarrit si shkak i rënies së rrufesë në rrjetin elektrik të banesës dhe djegia e plotë e rrjetit dhe paisjeve elektroshtëpiake..si dhe për akordimin e ndihmës financiare për familjen e shtetasit nga programi Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile,programi 3280,në mbështetje të VKB Malësi e Madhe nr 2 datë 11.01.2021 "për miratimin e buxhetit të vitit 2021 dhe programit buxhetor afat mesem 2021-2023 të Bashkisë Malësi e Madhe".

familjes së shtetasit

Baza Ligjore

Ligji nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar

Ligji për Prefektin e Qarkut

Ligji Nr. 45/2019 Për mbrojtjen civile,

VKM nr.329 datë 16/5/2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësitë e tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore"

VKM,Nr.965,datë 02/12/2015 „Për bashkëpunimin ndërinstucional të strukturave të drejtimit në rastet e emergjencave civile dhe krizave“.

Vendosi;

1. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Malësi e Madhe për mbështetje financiare të familjes së shtetasit Z. z. Pjeter Çukaj, objekti shtëpi banimi e të cilës është dëmtuar nga rënia e zjarrit si shkak i rënies së rrufesë në rrjetin elektrik të banesës dhe djegia e plotë e rrjetit dhe paisjeve elektroshtëpiake.

2. Të miratojë dokumentacionin tekniko - ligjor përkatës të hartuar nga Bashkia Malësi e Madhe për demtimin e banesë nga rënia e zjarrit si shkak i rënies së rrufesë në rrjetin elektrik të banesës dhe djegia e plotë e rrjetit dhe paisjeve elektroshtëpiake.

3. T'i akordojë familjes së shtetasit Z. Pjeter Çukaj, objekti shtëpi banimi e të cilit është dëmtuar nga rënia e zjarrit si shkak i rënies së rrufesë në rrjetin elektrik të banesës dhe djegia e plotë e rrjetit dhe paisjeve elektroshtëpiake, dhënien e ndihmës së menjëherëshme/emergjente financiare në vlerën/shumen 100.000 (njëqind mijë) lekë , në mbështetje të VKB Malësi e Madhe nr.2,datë,11.01.2021 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2021 dhe programit buxhetor afatmesëm



2021-2023 të Bashkisë Malësi e Madhe ”,nga fondi i buxhetit të Bashkisë Malësi e Madhe, nga Programi “Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile,programi 3280”.

4. T’i paraqesë dokumentacionin tekniko-ligjor përkatës të familjes së shtetasit **Z. Pjeter Çukaj**, objekti shtëpi banimi e të cilit është dëmtuar nga rënia e zjarrit si shkak i rënies se rrufesë në rrjetin elektrik të banesës dhe djegia e plotë e rrjetit dhe paisjeve elektroshtëpiake

5. Ndihma financiare për familjen e shtetasit **Z. Pjeter Çukaj**, përcaktohet sipas kritereve të VKM-së nr.329,datë 16.05.2012.

6. Ndihma financiare që do të akordohet do të përdoret për t’i ardhur në ndihmë familjes së shtetasit **Z. Pjeter Çukaj**, objekti shtëpi banimi e të cilit është dëmtuar nga rënia e zjarrit si shkak i rënies se rrufesë në rrjetin elektrik të banesës dhe djegia e plotë e rrjetit dhe paisjeve elektroshtëpiake

7. Vlera e dëmeve në orendi, mobilje dhe paisje elektroshtëpiake është 225.540 (dyqind e njezete e pese e pesqind e dyzet) leke. Dëmtime nga ana ndërtimore janë djegur komplet linjat elektrike të banesës me vlerë 164.221 (njqind e gjashtedhete e kater mije e dyqind e njezet e nje).

Vlera në total e dëmeve është : 389.761 (treqind e tetedhete e nente mije e shtateqind e gjashtedhete e nje) leke.

8.Ky vendim hyn në fuqi sipas nenit 55/6 të ligjit nr.139/2015 ”Për Vetëqeverisjen Vendore”.

KRYETAR

Ilir Halaj

SEKRETAR

Emirjan Hasmujaj

Miratuar me 26.02.2021

Vota Pro 17

Vota Kunder 0

Vota Abstenim 0

Zbardhur me datë 05.03.2021

